



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:182536
Datë: 06.03.2024
Numri i dokumentit: 05415649

C.A.P nr.1645/23,

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, nga Gjykatësi Individual Besnik Feka, në çështjen përmbareme të kreditorit të përmbaremit: V. S. nga P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B. R. avokate në P., ndaj debitorit të përmbaremit: A. S. nga G., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E.O. avokat në P., për kërkesën në të holla, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PPP.nr.817/2022, i datës 31.07.2023, me datë **06.03.2024**, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.REFUZOHET SI E PA BAZUAR ankesa e debitorit A. S. nga Gj., ushtruar përmes të autorizuarit të tij, avokat E. O. nga Prishtina, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PPP.nr.817/2022, i datës 31.07.2023, **VËRTETOHET.**

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, , me Aktvendimin PPP.nr.817/2022, i datës 31.07.2023, ka vendosur si në vijim:

Refuzohet i pabazuar, prapësimi i debitorit të përmbaremit: A.S. nga Gj.a, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Editon Osmani avokat në Prishtinë, i ushtruar kundër Urdhrit mbi caktimin e përmbaremit P.nr.65/2022 të datës 20.07.2022, të nxjerrë nga organi përmbareues-përmbareuesi privat I. I.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit të përcaktuar ligjor, ankesë ka ushtruar debitori A. S. nga Gjakova, përmes të autorizuarit të tij, avokat Editon Osmani nga Prishtina, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës përmbareme, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke e kundërshtuar në tërësi aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit dhe

aktvendimi i ankimuar të prishet dhe lënda të kthehet në ri vendosje në gjykatën e shkallës së parë, dhe të detyrohet kreditori që debitorit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës.

Përgjigje në ankesën e debitorit, brenda afatit ligjor ka ushtruar kreditori Vadat Salihu nga Prishtina, përmes të autorizuarës së tij, avokate Blerina Restelica nga Prishtina, duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet ankimore të debitorit, me propozim për gjykatën e shkallës së dytë që ankesa e debitorit të refuzohet e pa bazuar dhe aktvendimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykatësi Individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, 17 dhe 77 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194, 208 dhe 209, pika b) të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e debitorit A. S. nga Gj., ushtruar përmes të autorizuarit të tij, avokat Editon Osmani nga Prishtina, është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori me datën 20.07.2022, pranë organit përmbartues-Përmbartuesit Privat Isak Islami në Prishtinë, ka paraqitur propozim për lejimin e përmbartimit në bazë të në bazë të dokumentit notarial-kontratës mbi shitblerjen e aksioneve në Favera Holdind sh.a në pronësi të kreditorit, me numër LRP.nr.271/2022, me numër reference 104/2022, e datës 11.01.2022, kundër debitorit A. S. nga Gj., përmes së cilës kontratë palët kontraktuese në nenin 3 të kësaj kontrate, janë dakorduar që kreditori t'ia shes, ndërsa debitori ti blen aksionet e kompanisë "Favera Holding" sh.a me seli në Prishtinë e cila ishte në pronësi të kreditorit, dhe atë sasinë prej 1,2240 aksione, me vlerë nominale prej 1 euro për një aksion, dhe në nenin 4 të kësaj kontrate, palët janë pajtuar që çmimi I tërësishëm i shitblerjes së aksioneve nga shitësi të blerësi është shuma totale prej 80,000(tetëdhjetë mijë) euro, ndërsa sa i përket mënyrës dhe kohës së pagesës në nenin 5 të kontratës është specifikuar që pagesa e çmimit total prej 80,000 euro, të bëhet në 6 këste mujore dhe atë duke filluar nga data 15.01.2022 për pagesën e këstit të parë e deri me datën 15.06.2022 kur duhet të kryhet edhe pagesa e këstit të fundit e shumës së dakorduar për shitblerje të aksioneve.

Sa i përket aspekteve tjera kontraktuese, palët sipas kësaj kontrate në nenin 17 (dispozitat përfundimtare), par.5 i kontratës noteriale, janë dakorduar dhe kanë dhënë pëlqimin që ky akt notarial (kontrata mbi shitblerjen e aksioneve) ka fuqinë provuese dhe ekzekutuese në kuptim të Ligjit për Noterinë dhe Ligjit për Procedurën Përmbartimore, e një ashtu të njëjtit janë pajtuar që i njëjti akt notarial të ketë vlerën e dokumentit përmbartimor për të gjitha pagesat në të holla dhe detyrimet financiare që janë reciproke mes palëve, si dhe detyrimeve tjera të përshtatshme për përmbartim.

Organi Përmbartues-Permbartuesi Privat Isak Islami, me Urdhërin për Lejimin e Përmbartimit P.nr. 65/22, i datës 20.07.2022 e ka lejuar përmbartimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori A. S. nga Gj., përmes të autorizuarit të tij, avokat E. O. nga P., pas pranimit të urdhërit për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim kundër urdhërit për lejimin e përmbartimit, duke e kundërshtuar në tërësi propozimin për përmbartim dhe urdhërin për lejimin e përmbartimit, me arsyetimin se dokumenti përmbartimor mbi bazën e të cilit është inicuar procedura përmbartimore nuk i plotëson kushtet e përmbartueshmërisë, përkatësisht nuk e ka klauzolën e plotfuqishmërisë, e gjithashtu, debitorit së bashku me urdhërin për lejimin e përmbartimit nuk i është dorëzuar edhe dokumenti përmbartimor-akti notarial në bazë të së cilit është lejuar përmbartimi, e dhe mbi bazën e nenit 22 par.1, pika 1.3, në lidhje me nenin 36 të Ligjit për Procedurë Përmbartimore, në lidhje me nenin 43 të Ligjit për Noterinë, nuk i plotëson

kushtet për të qenë document përbarimor, mbi bazën e këtyre dhe arsyeve tjera të parashtruara në prapësim, i ka propozuar gjykatës shfuqizimin e urdhërit përbarimor.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit në prapësimin e ushtruar, me propozim që i njëjti të refuzohet i pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Urdhëri për Lejimin e Përbarimit.

Gjykata, e shkallës së parë, duke vepruar sipas prapësimit të debitorit dhe shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pa bazuar duke vendosur më specifikisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetimin e saj lidhur me mënyrën e vendosjes, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se gjykata, ka vlerësuar se dokumenti përbarues- Aktit Noterial – Kontratën mbi shitblerjen e aksioneve Nr.LRP.271/2022, Nr.Ref.104/2022, në pjesën që ka të bëjë me borxhin e kërkuar nga kreditori i përbarimit në shumën 50,000.00€, i plotëson kushtet për të shërbyer si titull ekzekutiv dhe bazë juridike për caktimin e përbarimit sipas nenit 21, 22 par.1.3 të LPP-së dhe nenit 43 par.1 të Ligjit për Noterinë Nr. 06/L-010, është i përbarueshëm sipas nenit 26 par.1 pasi është përcaktuar afati i përmbushjes së detyrimit, është i përshtatshëm sipas nenit 27 par.1 të LPP-së, për përbarim pasi në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar. Ndërsa pretendimet e debitorit në prapësim se organi përbarues me rastin e dorëzimit të urdhërit përbarimor nuk ka dorëzuar dokumentin përbarimor mbi të cilin mbështetet përbarimi, një pretendim i tillë nuk ishin me ndikim për gjykatën për faktin se debitori i përbarimit me asnjë provë nuk ka mundur t'i argumentojë pretendimet e cekura në prapësim, të cilat do të kishin ndikim që gjykata të vendos ndryshe nga ajo që ka vendosur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata sqaron se, në procedurë përbarimore nuk ka tagër të lëshohet në shqyrtimin e ligjshmërisë së titullit ekzekutiv. Në procedurën përbarimore vetëm bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të përcaktuar me dokumentin përbarues i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të përbarimit, të caktoi dhe zbatoi përbarimin, në një çështje përbarimore.

Gjykata, pas shqyrtimit të prapësimit, analizimit të shkresave të lëndës, si në dispozitiv të këtij aktvendimi ka vendosur, pasi pretendimet e debitorit të përbarimit në prapësim i ka vlerësuar të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, për arsye se provat e ofruara nuk i mbështesin pretendimet e tij ashtu siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, rrjedhimisht nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin pjesërisht ose në tërësi të aktvendimit mbi caktimin e përbarimit, apo për shtyrjen e zbatimit të përbarimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 61 par 1 pika 1 dhe nenit 71 par 1, pika 1 deri në 12 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (Ligji nr. 04/L-139), të Republikës së Kosovës.

Gjykata, nga arsyet e paraqitura si më lart, në bazë të nenit 73 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjithashtu, aktvendimi i atakuar me ankesë nuk është i shoqëruar as me shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore nga

neni 182 par.2, pika n) të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht si dhe e drejta materiale është zbatuar drejt.

Nga ekzaminimi i aktvendimit të goditur me ankesë, konstatohet se kreditori ka ushtruar propozim për përbarim kundër debitorit mbi bazën e aktit notarial-kontratës mbi shitblerjen e aksioneve në Favera Holdind sh.a në pronësi të kreditorit, me numër LRP.nr.271/2022, me numër reference 104/2022, e datës 11.01.2022, përmes së cilës kontratë palët kontraktuese janë dakorduar si në përmbajtje të dokumentit notarial, ashtu që, kreditori kërkon përmbushjen e dhunshme të ekzekutimit të detyrimit të pa përmbushur nga debitorit në shumën e mbetur prej 50,000 euro nga shuma totale e detyrimit sipas aktit notarial prej 80,000 euro, dhe gjykata e shkallës së dytë, duke ekzaminuar aktvendimin e goditur me ankesë, gjen se i njëjti, duke iu referuar nenit 22 par.1, nën par.1.3 në lidhje me nenin 26 par.1, si dhe nenit 27 par.1 të Ligjit për Procedurë Përbarimore nr. 04/L-139, në lidhje me nenin 43 par.1 dhe 6 të Ligjit për Noterinë nr. 06/L-010, i plotëson kushtet e dokumentit përbarimor si akt notarial, dhe është i përshtatshëm për përbarim, ashtu që, organi përbarues me urdhërin për lejimin e përbarimit, drejtë ka vepruar kur ka lejuar përbarimin, ngase duke marrë për bazë kontratën e noterizuar, dhe dispozitat kontraktuese të saj, vërtetohet se detyrimi i krijuar përmes aktit notarial tanimë është bërë i kërkueshëm dhe se duke iu referuar nenit 17, par. 5 të Kontratës mbi shitblerjen e aksioneve në Favera Holdind sh.a në pronësi të kreditorit, me numër LRP.nr.271/2022, me numër reference 104/2022, e datës 11.01.2022, të lidhur në mes të kreditorit dhe debitorit, konstatohet se palët kontraktuese me vullnetin dhe pëlqimin e tyre të lirë i kanë dhënë fuqi ekzekutive aktit notarial duke iu referuar nenit 43 të Ligjit për Noterinë nr. 06/L-010, në rastet e mospërmbushjes së kredisë në të holla-detyrimeve financiare të përcaktuara nga palët kontraktuese sipas nent 5 të aktit notarial-Kontratës mbi Shitblerjen e Aksioneve me numër LRP.nr.271/2022, me numër reference 104/2022, e datës 11.01.2022, ashtu që, gjykata e shkallës së dytë, i refuzon të pa bazuara pretendimet ankimore të debitorit se organi përbarues me rastin e lejimit të përbarimit debitorit së bashku me Urdhërin për Lejimin e Përbarimit dhe propozim për përbarim edhe dokumentin përbarimor në bazë të të cilit është kërkuar lejimi i përbarimit, ngase nga shkresat e lëndës, konstatohet se kreditori me rastin e dorëzimit të propozimit për lejimin e përbarimit, organit përbarues i ka dorëzuar edhe aktin notarial-Kontratën mbi Shitblerjen e Aksioneve me numër LRP.nr.271/2022, me numër reference 104/2022, e datës 11.01.2022, dhe konfirmimin e noterit se akti notarial është identik në përmbajtje dhe strukturë me aktin notarial që ruhet në arkivën e noterit, si dhe deklaratën noteriale nën betim me numër LRP.nr.8522/2022, të datës 11.07.2022, të dhënë nga kreditori Vedat Salihu, nga ku konfirmohet se të njëjtit sipas aktit notarial-dokumentit përbarimor Kontratës mbi shitblerjen e aksioneve në Favera Holdind sh.a në pronësi të kreditorit, me numër LRP.nr.271/2022, me numër reference 104/2022, e datës 11.01.2022, nga debitori i është përmbushë pjesërisht detyrimi dhe atë shuma totale prej 30,000 euro, detyrim ky që është paguar nga debitori në dy këste dhe atë kësti i datës 01.02.2022, në shumë prej 11,000 euro, dhe kësti tjetër i datës 11.03.2022 në shumë prej 19,000 euro, sipas konfirmimit bankar për dy pagesat e bëra të datës 04.07.2022, prandaj, duke iu referuar të gjitha këtyre konstatimeve të gjykatës së shkallës së parë, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë me vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, drejtë ka vendosur kur ka referuar pretendimet e parashtruara në prapësimin e debitorit, ngase, asnjëri nga pretendimet e tij nuk qëndrojnë dhe se debitori ka dështuar që me prova konkrete sipas nenit 69 par.4 të LPP-së, të argumentojë bazueshëmriinë e parashtrimeve në prapësim, prandaj në mungesë të kësaj, prapësimi i të njëjtit është refuzuar me të drejtë, dhe se edhe pretendimet ankimore të parashtruara nga debitori rezultojnë pretendime identike si në prapësimin e ushtruar të cilat nga debitori nuk janë arritur të vërtetohen, përkatësisht nuk është arritur të vërtetohet përmbushja eventuale e detyrimit të debitorit ndaj kreditorit për shumën e mbetur të detyrimit sipas aktit notarial të përbarueshëm në shumën e

mbetur prej 50,000 euro, e cila shumë sipas nenit 8 par.1 në lidhje me nenin 245 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, duhet ti përmbushet kreditorit nga ana e debitorit si detyrim i papërmbushur me kohë dhe afat të caktuar sipas aktit notarial i cili detyrim është bërë i kërkueshëm dhe i përmbarueshëm sipas aktit notarial-dokumentit përmbarimor të lartcekur.

Gjykata e Apelit, i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore të parashtruesit të ankesës, mirëpo, gjeti se të njëjtat nuk janë vendimtare dhe relevante në vendosje ndryshe, ashtu që, të njëjtat i refuzoi të pa bazuara dhe pa ndikim në vendimarrje ndryshe.

Prandaj, Gjykata e Apelit, mbi bazën e të lartcekurave, në mbështetje të nenit 17, 77 të LPP-së, në lidhje me nenin 194, 208, 209 pika b) të LPK-së, gjeti se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
C.A.P.nr.1645/23, me datë 06.03.2024

Gjyqtari Individual
Besnik Feka